Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 02-953
Datë: 08.10.2026

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060, për Kualifikimet Kombëtare, si dhe Udhëzimit Administrativ për Njohjen e Mësimit Paraprak (UA Nr. 31/2014, data 05.09.2014), dhe Udhëzimit Administrativ për Kriteret dhe procedurat për akreditimin e institucioneve që zbatojnë njohjen e mësimit paraprak në Kosovë (UA Nr.09/2019, data 18.06.2019), Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur më datë 07.10.2026 mjerrë këtë:

V E N D I M

1. NUK akreditohet Qendra për Aftësim Profesional (QAP) në Prishtinë për zbatimin e Njohjes së Mësimit Paraprak (NjMP) në kuadër të kualifikimit "Automekanik", Niveli III i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK), Kualifikimet Kombëtare Profesionale, me numër total prej 18 kredive, për shkak të mospërmbushjes së kritereve të përcaktuara për akreditim për zbatimin e NjMP-së.

A R S Y E T I M

2. Mosakreditimi i QAP Prishtinë për zbatimin e NjMP-së në kualifikimin "Automekanik", Niveli III, bazohet në të gjeturat e ekipit të ekspertëve gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, vizitës në institucion dhe vlerësimit të kapaciteteve institucionale, profesionale, materiale dhe procedurale të institucionit.

3. Në veçanti, QAP Prishtinë nuk ka përmbushur kriteret lidhur me:

3.1. Personelin adekuat për zbatimin e NjMP-së, veçanërisht në aspektin e përputhshmërisë së profileve profesionale të mentorit dhe vlerësuesve me kualifikimin "Automekanik", Niveli III;

3.2. Resurset materiale dhe pajisjet për vlerësim praktik, për shkak të mangësive të konstatuara në laborator, përfshirë mungesën e funksionalitetit/licencimit të aplikacionit/softuerit për identifikimin e gabimeve dhe pamjaftueshmërinë e pajisjeve dhe automjeteve për realizimin e vlerësimit praktik sipas kërkesave të kualifikimit;

3.3. Dokumentacionin dhe instrumentet e vlerësimit, pasi listat e kontrollit për vlerësim nuk janë të shoqëruara me detyra të përcaktuara për vlerësimin praktik dhe kriteret e vlerësimit të kandidatëve në dokumentacionin e dorëzuar nuk janë të qarta dhe të plota;

5. QAP Prishtinë rekomandohet që, para riaplikimit, të:

5.1. Plotësojë dhe harmonizojë stafin e angazhuar në procesin e NjMP-së me kërkesat e fushës profesionale të kualifikimit "Automekanik";

5.2. Caktojë mentor dhe vlerësues me përgatitje dhe kompetenca profesionale përkatëse në mekanikë ose mekatronikë, sipas kërkesave të përcaktuara;

5.3. Sigurojë që stafi i angazhuar në procesin e NjMP-së të jetë i trajnuar dhe i certifikuar për zbatimin e këtij procesi sipas kërkesave të AKK-së;

5.4. Përmirësojë laboratorin dhe pajisjet për vlerësimin praktik, duke siguruar funksionalitetin e pajisjeve dhe licencat e nevojshme për aplikacionet/softuerët e përdorur për identifikimin e gabimeve;

5.5. Plotësojë listat e kontrollit me detyra të qarta për vlerësimin praktik dhe të përcaktojë qartë kriteret dhe procedurat e vlerësimit individual të kandidatëve;

5.6. Përmirësojë dhe standardizojë dokumentacionin e procesit të NjMP-së, përfshirë dokumentet e portofolios, instrumentet e vlerësimit dhe dokumentacionin mbështetës;

5.7. Sigurojë që procesi i vlerësimit të kandidatëve të realizohet individualisht dhe me përbërjen e kërkuar të vlerësuesve.

6. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Në bazë të kërkesës së Qendrës për Aftësim Profesional (QAP) në Prishtinë për akreditim për zbatimin e Njohjes së Mësimit Paraprak (NjMP) në kuadër të kualifikimit ***"Automekanik"***, Niveli III sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve, me numër total prej 18 kredive, si dhe në bazë të procesit të vlerësimit dhe rekomandimeve të ekipit të ekspertëve, Këshilli Drejtues i AKK-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ekipi i ekspertëve ka bërë shqyrtimin e dokumentacionit të dorëzuar nga QAP Prishtinë më datë 26.03.2026 dhe ka realizuar vizitën në institucion më datë 30.03.2026. Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion, ekipi vlerësues ka analizuar kapacitetet institucionale, profesionale, materiale dhe procedurale të QAP Prishtinë për zbatimin e NjMP-së në kualifikimin "Automekanik", Niveli III. Raporti vlerësues është përpiluar më datë 11.08.2026.

Gjatë vizitës në institucion, paneli i ekspertëve ka vlerësuar kushtet e përgjithshme të hapësirave, laboratorit, pajisjeve, dokumentacionit dhe kapaciteteve të stafit. QAP Prishtinë është udhëzuar që të plotësojë dhe të dorëzojë dokumentacionin e nevojshëm edhe për procesin e validimit të programit, në mënyrë që të mund të shqyrtohen kërkesat për validim dhe më pas të vazhdohet me plotësimin e kritereve për akreditim për zbatimin e NjMP-së.

Ekipi i ekspertëve ka konstatuar gjithashtu se stafi i angazhuar në proces nuk kishte në tërësi njohuri të mjaftueshme dhe të dëshmuara lidhur me rolet, përgjegjësitë dhe procedurat e zbatimit të NjMP-së. Për këtë arsye, është rekomanduar që stafi i angazhuar të trajnohet dhe të përgatitet për procesin e NjMP-së në AKK.

Në aspektin e resurseve materiale, QAP Prishtinë ka paraqitur dokumentacion për pajisjet dhe materialet shpenzuese. Megjithatë, gjatë vizitës është konstatuar se pajisjet për identifikimin e gabimeve nuk ishin funksionale për shkak të licencimit të skaduar të aplikacionit/softuerit. Po ashtu, automjetet në laborator janë vlerësuar si të vjetra dhe jo plotësisht në nivelin e kërkesave për vlerësim praktik. Është evidentuar nevoja për pajisje shtesë, përfshirë motorë të demontuar me benzinë dhe naftë, në mënyrë që të sigurohen kushtet e nevojshme për vlerësim praktik të kandidatëve.

QAP Prishtinë ka paraqitur Memorandumin e Bashkëpunimit ndërmjet APRK-së dhe AAAPARRK-së si bazë për realizimin e vlerësimit në shkolla profesionale deri në plotësimin e kushteve laboratorike. Megjithatë, kjo zgjidhje nuk e eliminon nevojën që institucioni të sigurojë kapacitete dhe pajisje të përshtatshme dhe të qëndrueshme për zbatimin e procesit të NjMP-së.

Nga vlerësimi i përgjithshëm rezulton se QAP Prishtinë ka një pjesë të konsiderueshme të dokumentacionit dhe kapaciteteve institucionale për zbatimin e NjMP-së, por në momentin e vlerësimit **nuk i përmbush në tërësi kriteret e domosdoshme për akreditim**, veçanërisht në aspektin e personelit profesional, kapaciteteve dhe pajisjeve për vlerësim praktik, dokumentacionit dhe instrumenteve të vlerësimit, si dhe përgatitjes së stafit për procesin e NjMP-së.

Ekipi i ekspertëve ka rekomanduar që QAP Prishtinë në të ardhmen të paraqesë kërkesë për akreditim për zbatimin e NjMP-së vetëm pas plotësimit të stafit sipas kritereve të përcaktuara, përmirësimit të pajisjeve laboratorike, vazhdimit të licencave të aplikacioneve/softuerëve për identifikimin e gabimeve, trajnimit të stafit për procesin e NjMP-së dhe përgatitjes së detyrave praktike për secilën listë kontrolli.

Po ashtu, është rekomanduar që QAP Prishtinë të sigurojë përbërjen e nevojshme të panelit të vlerësimit, me tre vlerësues, dhe që në mungesë të vlerësuesve të brendshëm të angazhohen tre vlerësues të jashtëm që plotësojnë kriteret profesionale dhe kërkesat për NjMP. Vlerësimi i kandidatëve duhet të realizohet në mënyrë individuale.

Këshilli Drejtues i AKK-së, gjatë vendimmarrjes, ka marrë parasysh kërkesën e QAP Prishtinë, dokumentacionin e dorëzuar, shqyrtimin e dokumentacionit më datë 26.03.2026, vizitën në institucion më datë 30.03.2026, raportin vlerësues të përpiluar më datë 11.08.2026, të gjeturat e ekipit të ekspertëve dhe rekomandimet e tyre.

Duke marrë parasysh se mangësitë e evidentuara kanë të bëjnë me kritere themelore për sigurimin e cilësisë dhe vlefshmërisë së procesit të NjMP-së, në veçanti me stafin profesional, vlerësuesit, pajisjet për vlerësim praktik dhe dokumentacionin e vlerësimit, Këshilli Drejtues i AKK-së vlerëson se në këtë fazë nuk janë krijuar kushtet e nevojshme për akreditimin e QAP Prishtinë për zbatimin e NjMP-së në kualifikimin "Automekanik", Niveli III.

Mbi këtë bazë, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, bazuar në kompetencat e tij dhe në të gjeturat e procesit të vlerësimit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK-së, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.*

Vendimi u dërgohet:

1. Qendrës për Aftësim Profesional (QAP) në Prishtinë;
2. Arkivit të AKK-së.

Prof. Dr. Besim Mustafa

Kryetar i KD-së së AKK-së